

## RELACION

### Objekti i projektit:

**“Mbrotjtje lumore ne lumin e Gostimes, L =171m(vendi midis rruges dhe hidrocentralit) si dhe segmenti i prroit Sheh nga ura e Prroit deri tek vendtakimi me lumin e Gostimes ( 70 m + 10 m)”,  
Bashkia Librazhd**

Vendodhja e objektit është në fshatin Polis Sheh dhe Polis Gostime, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd. Aktualisht në segmentin që propozohet kjo ndërhyrje është vazhdim i një investimi të realizuar në vitin 2021. Investimi i realizuar është i llojit pritë lumore me gabiona që mbron një pjesë të tokave bujqësore por edhe rrugën auto Polis-Gostime dhe Polis-Sheh.

Gjendja fizike në terren paraqitet e vështirë. Rreshjet e shiut me intesitet të lartë sollën prurje të larta nga përroi Sheh në këtë zonë të shoqëruara me materiale inerte dhe aluvione nga pjerrësia e shpatit të malit depërtuan në rrugë, banesa dhe toka bujqësore duke dëmtuar infrastruksurën rrugore, prita lumore e tokat bujqësore.

Nga verifikimet e bëra nga grupi I sektorit të emergjencave civile në Bashkinë Librazhd duke qenë prezent, kane paraqitur situatë të vështirë me synim ruajtjen e jetës së njerezve në momentet e para dhe për rrjedhojë nuk pati rrezik për banoret dhe dëmtime serioze në banesat e tyre.

Nisur nga situatë e krijuar dhe dëmet e shkaktuara janë ngritur grupet e punës për konstatimin e gjendjes. Në bashkëpunim me inspektoriatin e mbrotjtjes së territorit, strukturat e policisë së rendit dhe ato bashkiake do të evidentohen të gjitha ndërhyrjet e kundërligjshme që janë bërë nga banorët që mendojnë se ishin një arsye tjetër e përkeqësimit të situatës.

Ky projekt ka qëllim mbrotjtjen lumore për të pakësuar dëmet që shkakton dalja e ujit.

Realizimi i projektit për ndërtimin e pritës emergjente në lumin Gostime, ka impakt të fshati Polis-Gostimë, fshati Polis-Sheh, fshati Fushë Buall. Përfitojnë rreth 800 banore si dhe 7 bizneset.

### ***Foto nga gjendja ekzistuese***







